

KOMUNIKATË PËR UEB

Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), TM1 2023

07.02.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për TM1 2023.

Shkalla e papunësisë në Kosovë 11.5%

Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 160 664) janë popullsi në moshë pune (45 387 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Persona aktiv ishin 7 413 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Persona joaktiv ishin 37 974 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Persona të punësuar ishin 17 090 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Persona të papunësuar ishin 24 503 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Tabela 1. Indikatorët kryesor të tregut të punës TM1 2023 / TM1 2022

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (NË MIJËRA)	TM1 2023			TM1 2022		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia punëtore (persona aktivë) (15-64 vjeç)	325 636	132 702	458 338	331 902	133 849	465 751
Persona joaktivë (15-64 vjeç)	251 864	450 462	702 326	269 638	470 662	740 300
Të punësuar (15-64 vjeç)	297 637	107 984	405 621	280 039	108 492	388 531
Të papunësuar (15-64 vjeç)	27 999	24 718	52 717	51 863	25 357	77 220
Të rinj të papunë (15-24 vjeç)	6 151	3 601	9 752	13 206	7 171	20 377
Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)	47 390	43 456	90 846	48 823	49 448	98 271
Punësimi i paqëndrueshëm (15-64 vjeç)	53 029	8 992	62 021	39 278	5 906	45 184
Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)						
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	56.4	22.8	39.5	55.2	22.1	38.6
Shkalla e joaktivitetit (15-64 vjeç)	43.6	77.2	60.5	44.8	77.9	61.4
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) (15-64 vjeç)	51.5	18.5	34.9	46.6	17.9	32.2
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	8.6	18.6	11.5	15.6	18.9	16.6
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	15.9	20.1	17.2	30.0	34.6	31.4
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	32.8	32.4	32.6	31.5	32.9	32.2
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	17.8	8.3	15.3	14.0	5.4	11.6

Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 4.9% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kurse përqindja e femrave të punësuar ishte 0.6% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e punësimit ishte 2.7% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e papunësisë ishte më e ulët për (-5.1) sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kurse tek të rinjtë (15-24 vjeç), shkalla e papunësisë ishte më e ulët për (-14.2%) sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë (60.5 %) më e ulët (-0.9%), krahasuar me në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e jo-aktivitetit tek femrat ishte shumë e theksuar me 77.2 %, krahasuar me meshkujt, 43.2 %.

Tregtia, ndërtimtaria dhe arsimiti prijnë me punësim

Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 20.1%, ndërtimtaria 10.7%, arsimin me 10.3%, prodhimi me 9.2%, administrata publike dhe mbrojtja me 8.5%, etj.

Femrat ishin të punësuar, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 53.8% të tyre. Ndërsa, meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë, prodhimit, administratë publike dhe mbrojtja, aktivitete akomodimi dhe shërbimesh, me 61.2%

Tabela 2. Të punësuarit sipas gjinisë dhe aktiviteteve ekonomike në TM1 2023, moshë 15+

Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	2.7	1.4	2.4
B - Minierat dhe xehoret	1.3	0.2	1.0
C - Prodhimi	10.0	6.9	9.2
D - Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	2.1	1.1	1.9
E - Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	1.3	0.2	1.0
F - Ndërtimtari	14.3	1.0	10.7
G - Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjeteve dhe motoçikletash	20.1	19.9	20.1
I - Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	7.7	6.9	7.5
H - Transport dhe depozitim	6.5	1.9	5.3
J - Informim dhe komunikim	2.1	2.5	2.2
K - Aktivitete financiare dhe sigurimesh	2.9	2.3	2.7
L - Aktivitete me prona të paluajtshme	0.1	0.2	0.1
M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2.7	4.1	3.0
N - Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3.6	5.0	4.0
O - Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	9.2	6.7	8.5
P - Arsimiti	6.3	21.3	10.3
Q - Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	2.6	12.5	5.2
R - Arti, zbavitja dhe rekreacioni	1.2	0.9	1.2
S - Aktivitete të shërbimeve të tjera	2.4	3.2	2.6
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak	0.2	0.5	0.3
U - Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.8	1.2	0.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Ky publikim ofron të dhëna statistikore për treguesit e tregut të punës bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore. Për realizimin e AFP-së, TM1 2023, metodologjia dhe standardet e aplikuar nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostat-it.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për TM1 2023 vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/tregu-i-punes>